



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK - GJINEKOLOGJIK
“MBRETËRESHA GERALDINË”
“NJËSIA E PROKURIMIT”

Nr. ____/ ____ Prot

Tiranë, më datë _____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale mjekimi për nevoja spitalore, e ndarë në lote, në SUOGJ ‘Mbretëresha Geraldinë’, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot), me afat 12 muaj”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Materiale Mjekësore të konsumueshme : 33140000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 64,842,994.26 (gjashtëdhjetë e katër milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër(4) pikë njëzet e gjashtë(26) qindarka) lekë pa TVSH. Kursi i Kembimit sipas Bankes se Shqiperise Përditesimi i fundit: 10.09.2025 12:26:58 euro 97.12 leke konvertohet, 667,658.50 (Gjashtëqind e gjashtëdhjet e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjet e tetë. 5) Euro pa TVSH

Lot.	Emërtimi	Shumatorja totale e cmimeve/njesi pa tvsh	Vlera pa tvsh	Vlera ne Euro
Lot.1	MM1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore	191,995.51	19,000,033.34	195634.61
Lot.2	MM2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore	76,363.56	21,950,072.60	226009.808
Lot.3	Materiale mjekimi ekstra	128,878.34	16,454,749.97	169426.997
Lot.4	Materiale konsumabile dhe implante post-operatorore	27,156.67	3,624,166.75	37316.3792
Lot.5	Materiale njëpërdorimshe për matje glicemie dhe transfuzion gjaku	186	563,750.00	5804.67463
Lot.6	Materiale njëpërdorimshe për mjekimin e plagëve dhe drenazhimin	44,270.00	2,789,365.60	28720.8155
Lot.7	Çorape elastike për profilaksinë e trombozës	1,152.14	460,856.00	4745.22241

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”** ka hartuar procesverbalin

për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): (nuk është i aplikueshëm)

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore.**

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në ligjin nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” i ndryshuar nën 21 e vijues. [...] Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore 1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, pajis me autorizimin për tregtim prodhuesit, vendas ose të huaj, që kanë regjistruar biznesin në Shqipëri, dhe tregtuesit me shumicë e tregtuesit me pakicë të pajisjeve mjekësore. 2. Rregullat për pajisjen me autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore dhe për revokimin e tij miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. [...] Urdhri Nr. 360 datë 22.08.2016 “Mbi procedurat dhe rregullat për regjistrimin e pajisjeve mjekësore, ndryshimet dhe anulimin e regjistrimit të tyre, dokumentacionin e nevojshëm dhe kostot përkatëse”; - Urdhri Nr. 734 datë 18.10.2018 “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr. 360 datë 22.08.2016 “Mbi procedurat dhe rregullat për regjistrimin e pajisjeve mjekësore, ndryshimet dhe anulimin e regjistrimit të tyre, dokumentacionin e nevojshëm dhe kostot përkatëse”. Gjithashtu, kriteri bazohet edhe në relacionin e argumentimit të fondit limit përcaktimin sasive të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim nga njësi e posaçme e ngritur me urdherin e titullarit të autoritetit kontraktor. Kriteri është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike

dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

- 2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet të paraqesë certifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose **ekuivalent** për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter i percaktuar në piken b) dhe c) është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktues për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

ISO 9001:2015, janë një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet **2022, 2023 dhe 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për lotin që ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 të njoftimit të kontratës

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë **vlerën e xhiros minimale**, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara me poshtë, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo më e vogël se **40 % e vlerës së fondit limit*** për të cilat konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një**

periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
-
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilin është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore. Për artikujt që kalsifikohen si pajisje mjekësore.**

Argumentimi: Bazuar në ligjin **ligji nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”** Ky ligj rregullon prodhimin, importin, shpërndarjen, vënien në dispozicion në treg dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore.

- **Neni 7/1** parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtimi me shumicë të pajisjeve mjekësore duhet të jenë të **autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë**.

Neni 10 ndalon tregtimin e pajisjeve mjekësore nëse subjekti nuk është i regjistruar dhe i pajisur me autorizim të vlefshëm. **Udhëzimi e vitit 2014, i Ministrisë të Shëndetësisë**, “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për marrjen e autorizimit për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore” Ky udhëzim specifikon dokumentacionin dhe kushtet që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë për të marrë autorizimin. **ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar**, neni 77 pika 1 përcakton se Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese **Certifikatë regjistrimi** nga **AKBPM** (Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore), për materialet mjekësore.

Argumentimi: Kriteri bazohet në **Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”** I ndryshuar parashikon që autoriteti kontraktor ka të drejtë të vendosë kritere të veçanta kualifikimi për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike, ligjore dhe profesionale për të përmbushur kontratën (neni 77 e vijues). Vendosja e këtij kriteri lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe është proporcional, pasi siguron që materialet e ofruara janë të regjistruara dhe të lejuara për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë. **Vendimi nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” I ndryshuar.**

Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, parashikon që importi, tregtimi dhe shpërndarja e materialeve mjekësore në Shqipëri mund të kryhet vetëm nga subjekte të pajisura me autorizim/certifikatë nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM). Kjo është një garanci ligjore për sigurinë, cilësinë dhe efektivitetin e produkteve që përdoren në sistemin shëndetësor.

Rregulloret e AKBPM (të miratuara me urdhra dhe udhëzime të Ministrit të Shëndetësisë) përcaktojnë se çdo material mjekësor që qarkullon në treg duhet të ketë certifikatë regjistrimi pranë Agjencisë. Kjo procedurë garanton se produktet kanë kaluar kontrolle teknike, dokumentacion të origjinës dhe janë në përputhje me standardet europiane të sigurisë dhe cilësisë. Vendosja e këtij kriteri është në funksion të **mbrojtjes së interesit publik**, pasi pajisjet dhe materialet mjekësore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e pacientëve. Prandaj, autoriteti kontraktor, në përputhje me nenin 2 të Ligjit për Prokurimin Publik, ka detyrimin të sigurojë që kontrata zbatohet nga operatorë ekonomikë që ofrojnë vetëm produkte të certifikuar dhe të kontrolluara nga organi përgjegjës shtetëror.

2.3.3 Kërkohe **Autodeklarate** e ofertuesit mbi origjinën e mallit (**vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese**) për secilin artikull, për plotësimin e afatit të skadencës së tyre, si dhe respektimit të specifikimeve teknike që oferton.

Argumentimi: Kriteri bazohet në **ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,** neni 77 e vijues, lejon vendosjen e kriterëve të veçanta teknike dhe dokumentuese që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke garantuar që operatori ofertues ka kapacitet të plotë për përmbushjen e kontratës dhe për të ofruar produkte të sigurta dhe të standardizuara. **Vendimi nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” I ndryshuar.**

Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, parashikon që çdo produkt mjekësor që importohet ose shpërndahet duhet të jetë i certifikuar dhe i identifikueshëm në mënyrë të qartë, duke përfshirë vendin e prodhimit dhe prodhuesin. Kjo siguron trasabilitet dhe kontroll mbi origjinën e materialeve, një element kyç për sigurinë e pacientëve.

Rëndësia teknike:

- Origjina dhe prodhuesi i materialit mjekësor ndikojnë në **cilësinë, përputhshmërinë me standardet teknike dhe afatin e skadencës.**

- Autodeklarata e ofertuesit siguron që materialet e ofruara janë të identifikueshme dhe mund të monitorohen gjatë gjithë ciklit të furnizimit dhe përdorimit.
- Garanton që materialet përmbushin specifikimet e kërkuara në dosjen e prokurimit, duke eliminuar riskun e furnizimit me produkte të pavlefshme ose me cilësi të ulët.

Siguria për autoritetin kontraktor dhe pacientët:

- Trasabiliteti i origjinës së materialeve mjekësore është i domosdoshëm për monitorimin e afateve të skadencës dhe për të shmangur përdorimin e produkteve të skaduara.
- Kjo mbron shëndetin e pacientëve dhe siguron përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret për pajisjet dhe materialet mjekësore.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autodeklaratë** për materialet mjekësore* Materialet në fjalë të jenë të certifikuara/markuara **CE ose FDA** bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse FDA ose CE/DC (Deklaratë Konformiteti, kur është e aplikueshme), origjinale ose fotokopje dhe nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në shqipe dhe të noterizohen.

Argumentimi: Kriteri bazohet në **ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar**, neni 77, lejon vendosjen e kriterëve të veçanta teknike dhe dokumentuese që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Kjo ka për qëllim të garantojë që operatori ka kapacitetin për të ofruar produkte të sigurta dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. **Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe pajisjet mjekësore”**, i ndryshuar, kërkon që materialet mjekësore të jenë të certifikuara sipas standardeve europiane (CE) ose amerikane (FDA), për të garantuar sigurinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat teknike dhe rregulloret në fuqi. **Rëndësia teknike:**

Certifikimi CE ose FDA siguron që materialet mjekësore **plotësojnë standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë**.

Bashkëlidhja e kopjeve të certifikatave ose Deklaratave të Konformitetit (DC) u jep autoriteteve kontraktore mundësinë të verifikojnë autenticitetin dhe vlefshmërinë e materialeve.

Përkthimi dhe noterizimi i dokumenteve në gjuhën shqipe siguron **qartësi dhe vlefshmëri ligjore** gjatë procedurave të prokurimit dhe të kontrollit pasues.

Siguria për autoritetin kontraktor dhe pacientët:

Materialet mjekësore pa certifikim ndërkombëtar ose me certifikata të paqartë nuk mund të përdoren, pasi rrezikojnë shëndetin e pacientëve dhe shkelin legjislacionin.

Ky kriter siguron **trasabilitet dhe kontroll të plotë** mbi cilësinë dhe sigurinë e materialeve të furnizuara.

2.3.5 Për të gjithë artikujt e Shtojcës nr. 5 të DST, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe/ose Sekretarisë **S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë**, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit: **“Blerje materiale mjekimi për nevoja spitalore, e ndarë në lote, në SUOGJ ‘Mbretëresha Geraldinë’, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë**

(me një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot), me afat 12 muaj” dhe jo para datës së hapjes së ofertave. (*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Shënim: (mostrat nuk duhet të jenë të skaduar).

Argumentimi: Kriteri bazohet në ligjin nr. 162/2020, neni 77, lejon vendosjen e kriterëve teknike të verifikimit të ofertave, për të garantuar furnizim me produkte të sigurta dhe të përshtatshme për përdorim spitalor. **Rëndësia teknike:** Dorëzimi i mostrave lejon verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike, origjinën, afatin e skadencës dhe standardet CE/FDA. Siguron që materialet e pranuar për përdorim spitalor janë të përshtatshme dhe të kontrolluara, duke reduktuar rrezikun për pacientët dhe institucionin.

Përfitimi për autoritetin kontraktor:

Ky kriter eliminon ofertat me materiale të pavërteta, të papërshtatshme ose të skaduar. Garanton transparencë dhe barazi mes ofertuesve, pasi të gjithë duhet të dorëzojnë mostrat sipas të njëjtave kushte. Ky kriter u vendos në mbështetje të "Relacion per argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta per kualifikim per objektin konkret te prokurimit, te hartuar nga njesi e posaçme e ngritur me Urdher te Brendshem nga ana e Titullarit te autoritetit kontraktor. Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vertetimin se operatori ekonomik i ploteson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 a) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". ku shprehet rrjedhimisht:

6. a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. Lidhur me këtë kriter, Autoriteti Kontraktor do të vlerësojë mostrat e paraqitura për efekt dokumentimi dhe vlerësimi nga specialistët përkatës të fushës. Ky proces është i domosdoshëm për të garantuar që produktet e ofruara nuk mbeten vetëm në nivel

specifikimesh teknike teorike, por përmbushin në praktikë kushtet e nevojshme për përdorim efektiv në shërbimin shëndetësor.

Në këtë pikë, vlerësimi i mostrave lidhet drejtpërdrejt me:

- Kushtet reale të përdorimit, për të siguruar që produkti është i përshtatshëm dhe funksional për situatat klinike konkrete;
- Mundësitë e përdorimit nga personeli mjekësor, duke shmangur produkte që, ndonëse përmbushin kriteret teknike të shkruara, janë të papërshtatshme praktikisht;
- Sigurimin e një vlerësimi sa më objektiv, pasi specialistët e fushës janë më të kualifikuarit për të gjykuar mbi cilësinë, përshtatshmërinë dhe lehtësinë e përdorimit të produkteve të ofruara.

Kjo qasje synon të garantojë që produkti final të jetë jo vetëm teknikisht në përputhje me kërkesat, por edhe realisht i dobishëm e funksional për mjekët dhe pacientët, duke rritur cilësinë e shërbimit dhe efikasitetin e investimit publik.

- 2.3.6 Për të gjithë artikujt e ofruar **te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull** (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktin që ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) të percaktuar në formularin e ofertës.

Argumentimi: Kriteri bazohet në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, lejon autoritetin kontraktor të vendosë kriteret të qarta dokumentuese dhe teknike, të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Kërkesa për katalogje është një mekanizëm i ligjshëm për **verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike**. Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe pajisjet mjekësore” dhe rregulloret e AKBPM kërkojnë dokumentacion të detajuar për çdo material mjekësor, për të garantuar sigurinë, cilësinë dhe përshtatshmërinë për përdorim spitalor.

Rëndësia teknike:

- Katalogjet e detajuara mundësojnë verifikim të menjëhershëm të **përputhshmërisë me standardet, specifikimet dhe kërkesat e DST**.
- Markimi i produkteve sipas Numrit Rendor të formularit të ofertës lehtëson **identifikimin e çdo artikulli**, duke shmangur konfuzionin dhe gabimet gjatë procesit të vlerësimit.
- Përkthimi dhe noterizimi i katalogut siguron **vlefshmëri ligjore dhe qartësi për komisionin e vlerësimit**, veçanërisht kur materialet vijnë nga prodhues të huaj.

Siguria për autoritetin kontraktor dhe pacientët:

- Ky kriter garanton që të gjithë artikujt e ofruar **janë të identifikueshëm, të kontrollueshëm dhe të përputhshëm me kërkesat teknike**, duke ulur riskun e furnizimit me materiale të papërshtatshme.
- Siguron **transparencë dhe barazi** mes ofertuesve, pasi çdo operator duhet të japë dokumentacion të njëjtë dhe të verifikueshëm. Ky kriter u vendos në mbështetje të “Relacion per

argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifik për objektin e prokurimit të hartuar nga Njesi e Posaçme e ngritur pranë AK-se me Urdher të Titullarit.

Ky kriter është vendosur nga specialistet e fushe që ka specialitet perkatese në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

